



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2016
Nr. Dok. 201401508/10

Lënda: *Rekomandohet ushtrimi kontrollit mbi veprimtarinë e ZVRPP, Tiranë, për zbatimin e legjislacioni, si dhe i gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetases I.B.*

Drejtuar : **Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Rregjistrimit Pasurive të Paluajtshme**
Z.Ilirian Muho

Për dijeni : **Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë,**
zj.Llambriola Misto

TIRANË

Zj. I.B
Adresa :

TIRANË

Z.Kryeregjistrues,

Në procesin e shqyrtimit të ankesës së shtetases I.B., në të cilën është prezantuar shkelja e së drejtës të pronësisë, Institucioni i Avokatit të Popullit, konsideron, se, qëndrimi që është mbajtur dhe mbahet prej ZVRPP, Tiranë, është i parregullt, dhe në cënim të parimit të ligjshmërisë, mbrojtjes së interes publik dhe të drejtave të personave private, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjshmërisë, sikurse parashikuar në nenin 9, 10, 12 dhe 14 të Kodit të Procedurës Administrative dhe të detyrueshëm në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Çështja për të cilën ankuesja ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, qëndron si më poshtë prezantuar.

Në cilësinë e pronares mbi pasurinë nr. 8/357, ZK 8150, Volum 23, faqe 108, ka aplikuar më datë 16.04.2014, përfaqësuesja e saj zj.LB për marrjen e shërbimeve sipas kodeve, sikundër përcaktuar në aplikimin e kësaj date.

Për të mundësuar marrjen e informacionit dhe shkaqeve të cilat justifikojnë mosdhënien e shërbimit të kërkuar prej ankueses, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka kërkuar në mënyrë të përsëritur me shkresat nr. K3/I52-2 prot, datë 12.09.2014, nr. K3/I52-4 prot, datë 05.12.2014 dhe nr.K3/I52-6 prot, datë 27.01.2015, arsyet e moslëshimit të dokumenteve të pronësisë në favor të ankueses, përfaqësueses së saj L.B.

Në përgjigje të aplikimit të kryer së fundmi, ZVRPP, Tiranë, me shkresën nr.765/1 prot, datë 23.01.2015, justifikon mosdhënien e informacionit dhe shpjegimeve duke u shprehur se;

“Në shkresën e depozituar pranë ZVRPP, Tiranë, theksojmë se nuk na është cituar nëse subjekti ankues ka kryer aplikim pranë ZVRPP, Tiranë, dhe gjithashtu nuk na rezulton bashkëlidhur shkresës së depozituar për trajtim, ankesa për të bërë të mundur gjykimin mbi problematikën.

Nga kërkimi në sistemin e aplikimeve në emër të palës ankuese theksojmë se nuk disponohet informacion kryerje aplikimi”.

Referuar shkresës nr. K3/I52-2 prot, datë 12.09.2014, të Institucionit të Avokatit të Popullit, rezulton të jetë përcaktuar data e aplikimit, 16.04.2014, personi që e ka kryer aplikimin, zj.L.B, si dhe numri i pasurisë, 8/357, ZK 8150, Vol 23, Fq 108, për të cilën kërkohet shërbimi sipas kodeve të përcaktuara.

Në këtë situatë, qëndrimi i shprehur si më sipërcituar prej ZVRPP, Tiranë, në vlerësimin tonë është parregullt, e në shkelje të detyrave funksionale për punonjësinë i cili ka pasur dhe detyrimin për dhënien e informacionit dhe shpjegimeve të kërkuara.

Në kushtet kur ZVRPP, Tiranë, nuk ka përmbushur detyrimin sikurse kërkuar prej Institucionit të Avokatit të Popullit, konform parashikimit të kryer në Ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, si dhe dhënien e shërbimit në afatin e përcaktuar për aplikimin e kryer me nr.20018, datë 16.04.2014, gjykojmë se, qëndrimi i ZVRPP, Tiranë, vjen në kundërshtim me parimet e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, si ai i ligjshmërisë, mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave privat, drejtësisë dhe paanësisë, të detyrueshme për zbatim në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Për arsyet e bëra me dije në këtë shkresë, Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”,* si dhe nenit 21/b, se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.*

REKOMANDOJMË

Ushtrimi kontrollit mbi veprimtarinë e ZVRPP, Tiranë, për zbatimin e legjislacioni, si dhe i gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetases I.B.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Kopje të ankesës datë 21.08.2014, të ankueses Idajete Bylyku drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kopje të kërkesës(aplikimit) nr.20018, datë 16.04.2014, të kryer prej zj.L.B.

Kopje të Shkresës nrK3/I52-2 prot, datë 12.09.2014, të Avokatit të Popullit drejtuar Regjistruesis të ZVRPP, Tiranë.

Kopje të Shkresës nrK3/I52-4 prot, datë 05.12.2014, të Avokatit të Popullit drejtuar Regjistruesis të ZVRPP, Tiranë.

Kopje të Shkresës nrK3/I52-6 prot, datë 27.01.2015, të Avokatit të Popullit drejtuar Kryeregjistruesis të ZVRPP, Tiranë.

Kopje të Shkresës nr.765 prot, datë 23.01.2015, të Kryeregjistruesis të ZQRPP, Tiranë, drejtuar Avokatit të Popullit.

Kopje të Shkresës nr.765/1 prot, datë 23.01.2015, të Kryeregjistruesis të ZQRPP, Tiranë, drejtuar Avokatit të Popullit.

Kopje të Shkresës nr.2278/1 prot, datë 05.03.2015, të Regjistruesis të ZVRPP, Tiranë, drejtuar Avokatit të Popullit.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERE

Etilda GJONAJ(SALIU)

**Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka**